

STAMBOLL (AA) - Presidenti i Republikës së Turqisë, Recep Tayyip Erdo?an, duke iu referuar zgjedhjeve të sotme parlamentare dhe presidenciale të mbajtura në këtë vend, tha se: "Lus Allahun që zgjedhjet e 24 qershorit të jenë në dobi për vendin dhe popullit tonë", raporton Anadolu Agency (AA).

"Rezultatet jozyrtare të zgjedhjeve u bënë të ditura, populli im më besoi detyrën e presidentit", theksoi presidenti Erdo?an.

Më tej, duke iu referuar zgjedhjeve parlamentare, Erdo?an tha se, "Qytetarët i dhanë përgjegjësi të madhe Aleancës Popullore dhe AK Partisë duke ua besuar shumicën në kuvend".